



ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE
UJËSJELLËS KANALIZIME BASHKIA KAMËZ SH.A
AKSIONARI I VETËM BASHKIA KAMËZ

V E N D I M

Nr. 01 datë 01/10/2019

Për

“Emërimin e Anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe Audituesit Ligjor/Ekspertit Kontabël të Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a”

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ligjit nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, dhe Statutit të Shoqërisë, Aksionari i vetëm i shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a, në mbledhjen e datës 01/10/2019.

V E N D O S I:

1. Emërimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a si më poshtë:

- Hasan Bara Anëtar
- Hajredin Murgu Anëtar
- Shpetim Leskaj Anëtar dhe Administrator/Drejtor i Përgjithshëm

2. Emërimin e Audituesit Ligjor/Ekspertit Kontabël të miratuar për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a për një periudhë 3-vjeçare si më poshtë:

- Vera Lala Liçensë Profesionale nr. 135 date 27.01.2005
- Valbona Merko Liçensë Profesionale nr. 137 date 28.01.2005

3. Ngarkohet Administratori i shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a, për regjistrimin e këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE
AKSIONARI I VETËM

BASHKIA KAMËZ
Z. RAKIP SËLI

KRYETAR



ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE
UJËSJELLËS KANALIZIME BASHKIA KAMËZ SH.A
AKSIONARI I VETËM BASHKIA KAMËZ

V E N D I M

Nr. 02 datë 01/10/2019

Për

“Miratimin e ndryshimit të Emrit dhe Selisë të Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a”

Në mbështetje të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, dhe Statutit të Shoqërisë, Aksionari i vetëm i shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a, në mbledhjen e datës 01/10/2019.

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të emrit së shoqërisë nga Ujësjiellësi Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a në Ujësjiellësi Kanalizime Kamëz sh.a (UKK sh.a)
2. Miratimin e ndryshimit të Selisë së shoqërisë Ujësjiellësi Kanalizime Kamëz sh.a nga Selia e regjistruar në adresën: **Rruga “5 Maji”, Tiranë**, në Selinë me adresë: **Bulevardi Blu, nr. 492, Kamëz**;
3. Ndryshimin e emrit dhe selisë në statutin e saj dhe regjistrimin e vendimit të ndryshimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
4. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE
AKSIONARI I VETËM

BASHKIA KAMËZ
Z. RAKIP SËLI

KRYETAR